



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo Komuna – Municipality Hani i Elezit



Raport gjashtëmuajor i Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje

1. Hyrje

Mekanizmi kundër Dhunës në Familje në Komunën e Hani i Elezit, si mekanizëm ndërinstitucional, ka funksionuar në përputhje me Rregulloren (QRK) – NR. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrotje nga Dhuna në Familje, Dhuna nga Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, i cili ka për synim përcaktimin e detyrate dhe përgjegjësive të Mekanizmit Koordinues Lokal për mbrojtjen dhe ofrimin e mbështetjes ndaj viktimate të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Mekanizmi Koordinues Lokal koordinon aktivitetet për parandalimin, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimate të të gjitha formave të dhunës pa diskriminim në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinë sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë bazë tjetër me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë. Mekanizmi Koordinues Lokal sigurohet në ruajtjen e konfidencialitetit të viktimate dhe mbrojtjen e të dhënave personale në pajtim me legjislacionin në fuqi. Mekanizimi Koordinues Lokal aplikon qasje me viktimën në qendër gjatë ofrimit të mbështetjes për viktimat e të gjitha formave të dhunës, duke i marrë parasysh të drejtat dhe nevojat e viktimate. Në këtë raport është bërë paraqitja e punës së seilit institucion anëtar gjatë periudhës raportuese, identifikimi i sfidave dhe rekomandimi i veprimeve përmirësimin e përgjigjes institucionale ndaj rasteve të dhunës në familje.

2. Pjesëmarrësit në Grupin e Mekanizmit Koordinues

2.1. Në bazë të Rregullore (QRK) – nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, ky mekanizëm ka këtë përbërje:

- Kryetari/ja i/e Komunës – Kryesues/e;
- Drejtori/esha i/e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale apo drejtori përkatës që mbulon fushën e shëndetësisë apo mirëqenies sociale;
- Drejtori/esha i/e Qendrës për Punë Sociale;
- Udhëheqësi/ja i/e Shërbimeve Sociale, Qendra për Punë Sociale;
- Drejtori/esha Komunal/e i/e Arsimit;
- Zyrtari/ja për Barazi Gjinore;
- Drejtori/esha i/e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;
- Përfaqësues nga Zyra për Komunitete dhe Kthim;
- Përfaqësues nga strehimorja;
- Përfaqësues nga OJQ-të në nivelin lokal aktive në të drejtat e njeriut/grave.

2.2. Në bazë të nenit 9 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, ftohen të jenë pjesë në Mekanizmin Koordinues Lokal:

- Mbrojtësi i Viktimateve nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimate;
- Përfaqësues nga Gjykata;
- Përfaqësues nga Prokuroria;
- Përfaqësues nga Policia;
- Përfaqësues nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas;
- Përfaqësues nga Zyrat e Punësimit;
- Përfaqësues nga Qendra e Shëndetit Mendor.

2.3. Në mungesë të Kryesuesit, rolin e Zëvendëskryesuesit të Mekanizmit Koordinues Lokal e ushtron Nënkyetari i parë i Komunës.

2.4. Mekanizmi Koordinues Lokal sipas nevojës mund të ftojë në takim edhe përfaqësues të institucioneve relevante.

2.5. Kryetari i Komunës për mbështetje administrative teknike cakton sekretarinë e Mekanizmit Koordinues Lokal.

3. Aktivitetet dhe raportimet nga institucionet anëtare deri me datën

30.06.2025

- **Zyra e Kryetarit të Komunës**

- Zyra e Kryetarit e ka përkrahur mbajtjen e dy takimeve të rregullta të Mekanizmit Koordinues kundër Dhunës në Familje, duke siguruar infrastrukturën logistike dhe çështje tjera të nevojshme.

- është rritur përkrahja buxhetore për aktivitete vetëdijësuese përmes bashkëpunimit me Zyrën për Barazi Gjinore dhe drejtive tjera relevante.

– Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale është e mandatuar të merret me parandalim, identifikim dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje.

Qendra për Punë Sociale ka kryer detyrat e saj për të gjithë rastet e raportuar gjatë këtij gjashtë mujori si: pjesmarrja në stacioni policor për mbrojtje të viktimate, referim të rasteve, vizita familjare, këshillime sociale dhe trajtim të rasteve.

Gjatë periudhës Janar -Qershori kemi pasur të referuara 4 raste të dhunës në familje.

Vlenë të theksohet se Qendra për Punë Sociale ka bashkëpunim të mire me gjithë akterët relevant për këto kategori dhe raste të tillë.

– Drejtoria e Arsimit

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional për parandalimin dhe adresimin e rasteve të dhunës në familje, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) për periudhën Janar- Qershori bën me dije se:

DKA ishte në monitorimi të vazhdueshëm dhe komunikimi të rregullt me institucionet arsimore (shkollat) në territorin e komunës, si informim nuk kemi pasur **asnje raportim zyrtar** që ndërlidhet me dhunën në familje e cila do të kishte shkaktuar:

- pengim të procesit mësimor të nxënësve,
- braktisje të shkollimit nga nxënësit, apo
- ndonjë ndikim tjetër serioz në përfshirjen e tyre në arsim.

DKA mbetet e përkushtuar që përmes personelit profesional dhe bashkëpunimit me drejtorët e shkollave, psikologët, dhe mekanizmat lokalë si QPS-në, të mbikëqyrë dhe raportojë në mënyrë të rregullt për mirëqenien e nxënësve në aspektin social dhe arsimor. Pas çdo dyshimi të rasteve tek fëmijët në shkolla, në bashkëpunim me ekipin, psikologun njoftohet qendra per punë sociale dhe identifikojnë rastet nëse duhet të ndermirren hapa konkret për të vërtetuar si rast të dhunës.

DKA Hani i Elezit bashkëpunon ngusht me shkollat dhe QPS-ën ku nga ky bashkëpunim së bashku edhe me policinë e Kosovës po punohet më shumë në sensibilizim dhe parandalim të dhunës.

– **Zyra për Barazi Gjinore**

- 31.01.2025 mbajtja e mbledhjes per KKSBB.
- Komuna e Hani të Elezit ishte nikoqire e Konferencës për Shkëmbimin e Praktikave dhe Përvojave të Mira në Qeverisje Komunale – një ngjarje rajonale e mbështetur nga OSBE-ja, që synon forcimin e qeverisjes së mirë në nivel lokal.
- Komunat Kaçanik, Ferizaj, Viti dhe Gjilan u bashkuan për të ndarë praktikat më të mira në:
 - Transparencë dhe llogaridhënie
 - Pjesëmarrje qytetare
 - Barazi gjinore në vendimmarrje
- Ky takim frytdhënës dëshmoi se kur bashkohen idetë dhe përvojat, ndërtohet një e ardhme më e mirë për të gjithë qytetarët tanë! Faleminderit të gjithë pjesëmarrësve për kontributin dhe përkushtimin në ndarjen e përvojave dhe ndërtimin e një qeverisjeje më të hapur, gjithëpërfshirëse dhe demokratike! Në ketë conference te pranishëm ishin 30 pjesëmarrës.



- Drejtoria e Arsimtit ka bërë ndarjen për subvencione student/e, 50 bursa ku në mesin e tyre ishin 36 vajza dhe 14 djem.
- Përfituesit e thirrjes publike për subvencionimin e bizneseve *start-up* dhe *bizneset ekzistuese* 2025, ku ne mesin e tyre ishin 6 burra dhe 1 grua, dhe ne fazën e II ishin perfitues 2 gra dhe një burre.

- **QMGF Shtepia Ime - Ferizaj**

Gjatë periudhës gjashtëmujore, në QMGF Shtëpia Ime – Ferizaj, nga Hani i Elezit janë referuar 5 raste, konkretisht një nënë me 4 fëmijë, arsyeha ka qenë dhuna në familje. Ky rast po trajtohet. Poashtu, së bashku me Policinë e Kosovës janë mbajtur ligjëratë.

– Policia e Kosovës – Stacioni Policor – Hani i Elezit

Në bazë të dhënave të grumbulluara gjatë periudhës janar-qershor 2025 në Han të Elezit janë evidentuar gjithsej katër raste të dhunës në familje. Rastet janë trajtuar në përputhje me procedurat ligjore dhe institucionet në fuqi, duke përfshirë: marrjen e deklaratave nga palët e përfshira, njoftimin dhe përfshirjen e organeve përkatëse, si: prokurori dhe Qendra për Punë Sociale, ofrimin e mbështetjes psiko-sociale për viktimat kur ka qenë e nevojshme, si dhe kërkimin dhe zbatimin e urdhërave mbrojtës nga Gjykata.

Në muajn shkurt saktësisht me datën 03.02.2025, si dhe me datën 04.02.2025 kanë qenë dy raste të dhunës në familje 2025-HE-12 dhe 2025-HE-14, ku këto dy raste kanë qenë të së njëjtës familje dhe kryesi ka qenë i njëjtë dhe poashtu të njëtit iu është caktuar masa e ndalimit policor dhe më pas dënimini me burg. Viktimës së këtij rasti për shkak të rrezikut të përsëritjes së dhunes dhe mungesës se mbështetjes familjare ka qene e vendosur ne strehimore për disa ditë në mënyrë të mbrojtjes së përkohshme dhe përkujdesjes psiko-sociale derisa është gjetur kryesi i kësaj vepre penale.

Në muajin mars poashtu kemi patur dy raste të dhunës në familje saktësisht me datën 03.03.2025 (2025-HE-20) ku viktimës iu është lëshuar edhe urdhëri mbrojtës nga gjykata dhe rasti i datës 14.03.2025 (2025-HE-22), dhe palët e dyshuara për kryerjen e këtyre veprave penale janë liruar në procedurë të rregullt.

Nga këto katër raste të gjitha janë të raportuara nga viktimat femra.

Vëretje mbi mungesën e mbrojtësit të viktimate .

Megjithëse ligji parasheh përfshirjen aktive të mbrojtësit të viktimate në rastet e dhunës në familje, në praktikë gjatë kësaj periudhe në asnjërin prej rasteve të evidentuara nuk ka qenë prezent një mbrojtës i viktimës. Mungesa e këtij mekanizmi përbën një mangësi serioze në procesin e mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimate kështu që shpresojmë që të aktivizohet dhe të jetë funksional roli i mbrojtësit të viktimate në mënyrë që të sigurohet mbështetje e plotë dhe të garantohet një trajtim dinjitoz për viktimat e dhunës në familje. Institucioni ynë mbetet i përkushtuar në parandalimin dhe trajtimin e çdo forme të dhunës në familje, duke vazhduar bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse dhe shërbimet përkatëse sociale.

4. Sfidat e evidentuara

- Mungesa e burimeve financiare për intervenime të menjëherëshme
- Kapacitetet e kufizuara për strehim afatgjatë të viktimate
- Nevoja për koordinim më të strukturuar ndërmjet institucioneve në rastet urgjente.
- Niveli i ulët i raportimit të dhunës nga burrat dhe të moshuarit.

5. Rekomandimet

- Hartimi i një Plani të Veprimit Komunal për Parandalimin e Dhunës në Familje 2025–2027.
- Krijimi i një mekanizmi të përbashkët të të dhënave për rastet e dhunës.
- Trajnime të vazhdueshme për stafin ndërinstitucional mbi qasjen e bazuar në të drejtat e viktimateve.
- Zgjerimi i bashkëpunimit me mediat lokale për vetëdijesim.
- Mbështetje e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve për të parandaluar dhunën ndaj tyre brenda familjes.

Përgatiti:

Sekretaria e Grupit Koordinues

Komuna Hani i Elezit



Miratuar nga:

Kryesuesi i Grupit Koordinues

Data: 04.07.2027